



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME

Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-4558/20 datë:20.02.2020



Npi – 01/64 datë: 26.02.2020

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.7 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve 01Nr.06/2005-43, Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 26.02.2020 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S S Ë -II- T Ë K O M I T E T I T P Ë R K O M U N I T E T E

E mbajtur më: 26.02.2020 (e mërkurë) në ora 14.00 h. në sallën Nr.01.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit për Komunitete: z.Rrahman Kadrija, znj.Fatmire Ferati, z.Muhamet Ademaj, znj.Diarta Vishesella, dhe z.Arton Demiri, kanë marrë pjesë edhe: Nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, shefi i zyrës z.Ibrahim Demiri; Zytari për Informim z.Lulzim Sahiti; Zytari Ligjor, z.Lulzim Muharremi; Zytari për barazi gjinore, z.Reshat Gashi; Nga OSBE-ja z.Muharrem Haziri dhe Gazmend Piraj; Nga UNMIK-u Nevzat Qorrolli, dhe shefi i UNMIK-ut; Praktikanti, z.Egzonit Jakupi; Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Rrahman Kadrija, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 31.01.2020,
2. Analiza e gjendjes së përgjithshme të familjeve të komunitetit ashkali dhe rom-pas vizitës në terren (Shtime, Gjyrkovc, Vojnovc dhe Davidovc),
3. Planifikimi dhe realizimi i takimeve me përfaqësuesit e Divizionit për Komunitete, në MKK dhe Organizatat e tjera, lidhur me mundësitë e mbështetjes për çështjet e evidentuara (përgatitja dhe paraqitja e kërkesave të specifikuara, në bashkëpunim me ZKKK-në),
4. Informatë nga ZKKK për aktivitetet mujore (shefi i ZKKK-së),
5. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 31.01.2020,

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi ekstrakt procesverbalin nga mbledhja e kaluar e mbajtur më 31.01.2020.**

Pika 2

Analiza e gjendjes së përgjithshme të familjeve të komunitetit ashkali dhe rom-pas vizitës në terren (Shtime, Gjyrkovc, Vojnovc dhe Davidovc)

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Ne anëtarët e KPK-së dhe shefi i zyrës për komunitete kemi dalë në teren dhe kemi identifikuar 18 raste më ekstreme që nevojiten për ndërtimin e shtëpive për banim. Ato i kemi listuar dhe sigurisht që do ti kompletojmë dokumentacionin dhe do të bëjmë kërkesë qoftë në Ministrinë për Komunitete qoftë edhe te do donatorët.

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, po bisedojmë për pikën e dytë të rendit të ditës. Pjesa dërmuese e pjesëtarëve të komuniteteve ashkali e rom jetojnë në kushte të vështira. Ne i kemi vizituar ato dhe kemi pa se ato jetojnë ose me pension ose presin ndonjë ndihmë nga bota e jashtme. Ka shumë OJQ-ë por vërtetë pak kanë ndihmuar. Kemi pa një familje të cilës ju ka kallë shtëpia dhe tani jeton në kushte të rënda në të ftohtë. Duhet Qeveria që të bëjë një zgjidhje.

znj.Fatmire Ferati; Përshëndetje, ne e kemi pa nga afër gjendjen e këtyre familjeve. Konsideroj se primare është siguri i strehimit për këto familje skamnore. Ne në vendin e ngjarjes kemi bërë edhe fotografi dhe po mendoj që duhet me e kompletuar dokumentacionin dhe me ua dërguar Ministrisë, për të bërë ndonjë zgjidhje. Këto dokumentacione duhet me i kompletuar ZKKK-ja secilën veç e veç dhe me i adresuar në departamentin përkatës të Qeverisë. Ne si Komunë kemi buxhet shumë të vogël për me mundur me i ndihmuar ndonjërit në ndërtimin e shtëpisë. Buxhetin që e ndajmë ne dikund rreth 6000€ ka mundësi vetëm sa për ndonjë pako ushqimore ose pagesën e ndonjë qiraje për nevoja tepër të domosdoshme. Për këtë arsye unë propozoj që ta miratojmë një Rekomandim për ZKKK-në që të përgatit dokumentacionin për këto 18 raste dhe ti dërgon në qendër.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -II- për vitin 2020, të mbajtur më: 26.02.2020, unanimisht i rekomandon, Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim që listën e prezantuar në mbledhjen e Komitetit për Komunitete, për gjendjen e rëndë të banimit të 18 familjeve, ta përgatitë si kërkesë e cila do t'i dorëzohet Ministrive relevante, Zyrrave në nivel qendror, dhe Donatorëve, me arsyeshmërinë dhe dëshmitë për gjendjen e banimit për secilin rast veç e veç.**

Pika 3

Planifikimi dhe realizimi i takimeve me përfaqësuesit e Divizionit për Komunitete, në MKK dhe Organizatat e tjera, lidhur me mundësitë e mbështetjes për çështjet e evidentuara (përgatitja dhe paraqitja e kërkesave të specifikuara, në bashkëpunim me ZKKK-në)

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Ibrahim Demiri.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Përshëndetje, ne kemi vizituar familjet e komuniteteve rom e ashkali, ku jemi njoftuar për së afërmi me kushtet e banimit të disa rasteve shumë të rënda. Kemi konstatuar që është çështje urgjente zgjidhja e problemit të banimit për këto familje. Ky problem nuk zgjidhet vetëm me kërkesa pa bërë ndonjë hap konkret. Ne në Komunë e dimë që e kemi buxhetin e vogël për me mundur me bërë diçka më shumë. Ministria më shumë po merret me rastet e kthimit. Për këto 18 raste, ne i kemi hartuar kërkesat i kemi kompletuar dhe i kemi prioritetizuar. Me OJQ "VORAE" kemi planifikuar që të punojmë së bashku në projekte me 50%. Kemi kontaktuar po ashtu edhe OJQ "KATARI" dhe gjatë konsultimeve jemi marrë vesh që mund të adresojmë kërkesat e komuniteteve për shtëpi banimi. Meqenëse Kuvendi ka ndarë një lokacion për banim kolektiv, ku mendoj se ne mund të konkurrojmë me ndonjë projekt për banim kolektiv.

Te pika 3 konstatoj se janë planifikuar takimet në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, dhe kemi realizuar takimet me organizatat e ndryshme që mund të ndihmojnë në çështjen e banimit e strehimit të cilave do të ua dërgojmë kërkesat e specifikuara.

Pika 4

Informatë nga ZKKK për aktivitetet mujore

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Ibrahim Demiri.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Informatën e kemi përgatitur në formë të shkruar dhe ua kemi dërguar.

1.Kthimi: Gjatë muajit Shkurt nuk ka pasur asnjë kërkesë për kthim. Lidhur me kthimin, më 26.2.2020, kemi marrë pjesë në Tryezën e rrumbullakët për çështjet që ndërlidhen me personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV), procesin e kthimit nga pikëpamja e koordinimit dhe bashkëpunimit më të mirë mes organeve përgjegjëse, të cilën e ka organizuar Ministria për Komunitete dhe Kthim përmes UNMIK-ut dhe UNHCR-së.

2.Riatdhesimi: Gjatë këtij muaji nuk ka pasur të riatdhesuar.

3.Aktivitetet për zbatimin e Planit Komunal të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve RAE2013-2015

Dita e Flamurit të Komunitetit Ashkali, 15 Shkurti, në Shtime, është shënuar me aktivitete sportive dhe program kulturor, të shfaqura nga të rinjtë e Organizatës “ASU”, nga Shtimja. Ndërkaq në Ferizaj, është mbajtur manifestimi qendror për nder të festës së Flamurit të Komunitetit Ashkali, ku ka marrë pjesë një numër i qytetarëve të komunitetit Ashkali nga Shtimja. Këshilli Organizativ për shënimin e kësaj dite ka kërkuar nga DKRS-ja përkrahje financiare për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve të organizuara në shumën prej 480€, e cila kërkesë ende është në procedurë të realizimit. Sa i përket ndërtimit të shtëpive nga MPMS, për komunitetin Ashkali dhe Rom, në komunën e Shtimes, pas vizitave që kemi bërë, kemi konstatuar se pesë shtëpi janë në përfundim e sipër, një ende nuk ka filluar të ndërtohet për shkak të kohës së dimrit. Pritet që në ditët në vijim të fillojë ndërtimi i saj dhe përfundimi i plotë i 5 të tjerave.

4.Vështirim i përgjithshëm i komuniteteve: ZKKK-ja ka pranuar kërkesën e Bekim Emrushit për ndihmë të riparimit të shtëpisë, e cila është dëmtuar nga zjarri, ditë më parë. Këtë kërkesë i rekomanduar Komisionit për Shqyrtim dhe Vlerësim të Kërkesës/ave për Subvencione sipas Rregullores për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve të Komunës- Shtime Nr.01-060/0124495/17, por që Komisioni ende nuk ka filluar punën.

5. Projektet në terren për komunitetet dhe përfituesit si dhe bashkëpunimi me palët e interesuara-aktivitetet e ndërgjegjësimit publik: Pas kontakteve të vazhdueshme me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM) jemi në pritje të hapjes së konkursit për të aplikuar pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali me projekte të tyre konkrete, qofshin ato biznese fillestare apo ato ekzistuese. Programi për Stabilizimin e Komuniteteve IV (EU-CSP III) është projekt i cili financohet nga BE dhe menaxhohet nga Zyra e BE-së në Kosovë. Programi EU-CSP III do të ofrojë asistencë financiare dhe teknike për fillim të bizneseve të vogla apo zgjerim të atyre ekzistuese sidomos të atyre bizneseve që promovojnë dhe forcojnë reintegrimin e qëndrueshëm të anëtarëve të kthyer të komuniteteve jo-shumicë. Projekti EU-CSP III po ashtu do të përkrahë edhe iniciativat e komunitetit prej të cilave komuniteti do të ketë përfitim më të gjerë duke punuar me pjesëtarët e komunitetit dhe fermerët individualë dhe prodhuesit për të eksploruar mundësitë për aktivitete të përbashkëta përmes krijimit dhe mbështetjes së asociacioneve të biznesit të komuniteteve jo shumicë dhe ato ndëretnike. IOM-i do të financojë bizneset që mund të dëshmojnë realizueshmëri dhe qëndrueshmëri ekonomike dhe që ofrojnë mundësi punësimi e krijim të të ardhurave.

6.Çështje të tjera ose aktivitetet: Me 18.2.2020 kemi vizituar dhe kemi mbajtur një takim me drejtuesit e Organizatës “Qatar Charity” dhe kemi kërkuar ndihmën për ndërtim të shtëpive, për serra, motokultivator dhe pajisje bujqësore, për familjet që posedojnë tokë bujqësore.

Pas këtij takimi kemi organizuar një vizitë në terren me anëtarët e KPK për verifikim të gjendjes së banimit të komunitetit me ç’rast kemi konstatuar se 18 familje kanë nevojë për ndërtim të shtëpisë.

Për këto familje kemi përgatitur kërkesën duke konstatuar se nga ky numër 2 familje nuk posedojnë pronë për ndërtim shtëpie dhe dy të tjera në mungesë të pronës mund të zgjidhen duke bërë mbindërtim në objektet ekzistuese. Në këtë listë kemi përfshirë edhe dy familje të komunitetit shqiptar.

Gjithashtu kemi përgatitur listën e përfituesve të mundshëm për mjete bujqësore (7 kërkesa) dhe serra (39 kërkesa) si dhe motokultivator (10 kërkesa). Më 19.2.2020 kemi mbajtur një takim me z. Izmet Nazifi , përfaqësuesi i OJQ "VORAE" në Departamentin e ndërtimit, me të cilin kemi diskutuar rreth mundësive të kyçjes në projektin e ndërtimit të shtëpive për vitin 2020. "VORAE" është aktive në komunat e tjera sa i përket strehimit dhe banimit, por te ne ekziston problemi me buxhetin për participim në projekte kur dihet që "VORAE", mund të financojë vetëm me 50 % .

Ne kemi problem të sigurojmë 50% të mjeteve të nevojshme në këto projekte pasi që paraprakisht duhet të ekzistojë një Memorandum i nënshkruar nga Komuna dhe "VORAE". Sa i përket vizitave në terren, ZKKK-ja ka vizituar edhe familjen e Bekim Emrushit nga Shtimja, të cilit i është dëmtuar shtëpia nga zjarri dhe te familja e Xhemajl Ilazit në Gjyrkovc, të cilit është duke iu riparuar shtëpia me ndihmën e individëve dhe bizneseve në baza vullnetare.

Rasti i Bekim Emrushit ka përfunduar përmes aksionit vullnetar, kurse te Xhemajl Ilazi punimet janë në përfundim e sipër (është duke u bërë vendosja e dymëve të brendshme, përderisa punët tjera kanë përfunduar – shumica në bazë vullnetare përmes iniciativës së Kryesuesit të Komitetit për Komunitete.

7. Buxheti: ZKKK-ja në këtë periudhë ka pasur të alokuara 500 € nga buxheti i subvencioneve dhe nga kjo shumë 400€ i ka dedikuar për ndihmë familjes së Bekim Emrushit, për riparim të shtëpisë së dëmtuar nga zjarri.

z.Arton Demiri: Përshëndetje, po ndërlidhem te rasti i Zekë Demirit, ai ka hy në kredit vetë por edhe I kanë ndihmuar edhe pjesëtarët e komunitetit rom, për me e ndërtuar një shtëpi banimi prej 65 metrave katror, dhe ka arrit me e kompletuar diqysh. Kështu që tash faktikisht po bëhen dy shtëpia për familjet Demiri, dhe për këtë duhet ta falënderoj edhe Komunën.

z.Muhamet Ademaj: Po e shohim që pjesëtar të komunitetit pakicë në komunën e Shtimes janë pjesëtarët e komunitetit rom dhe ashkali. Unë jam i mendimit se ne duhet ta kemi një vijë buxhetore për zgjidhjen e këtyre problemeve, sepse po ka pare për luks e mos me pas pare për zgjidhjen e këtyre problemeve jetike të banorëve të komunës tonë.

Pika 5

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Ademaj: Ka qenë mirë që ne me organizuar një aksion, për me i grumbulluar mbeturinat që ishin te shtëpia e Xhemajl Ilazit në fshatin Gjyrkovc me i futë në qese najloni dhe me i vendos pranë rrugës dhe pastaj Kompania "Pastërtia" me shkuar dhe me i marrë.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15.32 h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Rrahman Kadrija